



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1672/1 Prot.

Tiranë, më 27 / 11 / 2018

V E N D I M

Nr. 241, Datë 27 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën Nr. 69, datë 22.05.2018, të paraqitur nga subjekti ankues Sh.S kundër Postës Shqiptare sh.a Filiali Mat në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se, me shkresën nr.210, datë 13.03.2018 është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar në detyrën si Përgjegjës i Zyrës Postare Komsu, Filiali Mat. Ankuesi informon se, veprimet tendencioze për largimin e tij nga puna, kanë filluar që në datë 19.12.2017 kur është nxjerrë Urdhri i Brendshëm nr. 38, “Për kalim nga fuqi punëtore në punonjës me kohë të pjesshme” nga Filiali i Postës Mat, urdhër i cili është revokuar me shkresën nr.39, datë 22.01.2018 pas ankesës që kishte bërë Sh.S tek Drejtori i Përgjithshëm. Por veprimet diskriminuese ndaj tij kanë vazhduar më tej nëpërmjet organizimit të një programi kontrolli në Zyrën Postare Komsu nga Filiali i Postës Mat. Në përfundim të këtij kontrolli ka dalë relacioni i grupit të kontrollit në të cilin ka rezultuar se ka patur parregullsi nga ana e punonjësit Sh.S në kryerjen e detyrës. Bazuar në përfundimet e kontrollit, Filiali i Postës Mat me Urdhrin nr. 30, datë 08.02.2018 ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për Sh.S. Me shkresën nr.163, datë 26.02.2018 të Drejtorit të Filialit Mat, Sh.S është njoftuar mbi fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, për parregullsi dhe mospërbushje të detyrës në kohë, cilësi e efektivitet siç ka rezultuar edhe në konstatimet e dokumentuara në akt-kontrollin e datës 08.02.2018.

Subjekti ankues shpjegon se motivacioni i largimit të tij nga puna ka qenë diskriminues dhe e ka vendosur atë në një trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë me punonjësit e tjerë, duke u marrë rreth tri muaj me ankuesin, vetëm për ta larguar nga puna, për shkak të bindjeve politike.

¹ Sh.S është anëtar i subjektit politik: “Lëvizja Socialiste për Integrim” e vërtetuar me kartën e anëtarësisë nr.5736, datë 22.04.2016, si dhe Vërtetim nr.16, datë 16.05.2018 të lëshuar nga subjekti politik LSI, dega Mat.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, Sh.S, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

- A. Me shkresën Nr. 717/1, datë 30.05.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Posta Shqiptare Filiali Mat, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga Sh.S.
- B. Me shkresën datë 30.05.2018, subjekti ankues ka informuar se nga Posta Shqiptare Filiali Mat janë larguar nga detyra shtetasit: L.S, ish drejtore e postës, D.S Zyra Postare Xibër, A.K Zyra Postare Klos, H.G Zyra Postare Macukull, Sh.Z Zyra Postare Lis dhe A.K transferuar në Dibër, të gjithë këto anëtarë të LSI-s. Nga ana e drejtorisë nuk është ushtruar kontroll në pikat e Filialit Burrel, Zyrat Postare: Ulëz, Baz, Lis, Suç, Derjan, Gurrë si dhe në Filialet e Postës Klos.
- C. Me shkresën nr.392/1, datë 06.06.2018 Filiali i Postës Mat ka kërkuar nga Komisioneri kopje të plotë të ankesës së bërë nga subjekti ankues.
- D. Me shkresën nr.712/2, datë 11.06.2018 nga ana e Komisionerit i është dërguar Filialit të Postës Mat kopje e plotë e ankesës së Sh.S.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën Nr. 392/3, datë 14.06.2018 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Posta Shqiptare sh.a, Filiali Mat në mes të tjerash sqaroi se: *“Zgjidhja e kontratës individuale të punës të Sh.S është bazuar në shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mënyrë të përsëritur në kryerjen e shërbimeve nga ana e ish punonjësit Sh.S, faktuar në raste konkrete të dokumentuara në relacionin e programit të kontrollit nr. 69, datë 08.02.2018, shkelje të cilat janë në kundërshtim me: - Rregulloren e Shërbimit Bazë Postar. – Udhëzimin nr.3, datë 23.02.2015 “Mbi ndjekjen e procedurave në zbatim të Marrëveshjes nr.4573 të I.S.Sh dhe nr.1932 Posta Shqiptare sh.a” si dhe Marrëveshjes nr.3341 të ISSH dhe nr.2038 të Posta Shqiptare sh.a, datë 12.06.2014, për Kryerjen e Shërbimeve në pagesat e pensioneve. – Shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme nr.4545/2, datë 30.12.2015 “Mbi zbatimin e marrëveshjes nr.1932/4537, datë 21.08.2008 dhe 2038/3341, datë 12.06.2014 me Sigurimet Shoqërore”. Bazuar në mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në veprimtarinë e punës së ankuesit Sh.S, vërtetohet se praktika që është ndjekur nga ana jonë është e bazuar në referenca ligjore dhe fakte konkrete e për këtë arsye nuk është tendencioze ashtu siç pretendohet. Nga grupi i punës që kanë zhvilluar kontrollin janë konstatuar shkelje të disiplinave financiare dhe Rregullores Bazë Postare. Kontrollat janë kryer në disa Zyra Postare dhe janë në proces të gjitha zyrat postare sipas programit. Nga kontrollet e zhvilluara në zyrat e tjera postare dhe konkretisht në Zyrën Postare Macukull, Program Kontrolli nr.139, datë 15.02.2018 dhe në Zyrën Postare Xibër me nr.138, datë 13.02.2018 janë konstatuar shkelje dhe parregullsi të përafërta me shkeljet e konstatuara në Zyrën Postare Komsit dhe në përfundim janë zgjidhur marrëdhëniet e punës për shkaqe të justifikuara me ish punonjësit H.G dhe D.S. Sa më sipër vërtetohet se nuk jemi në kushte diskriminuese por jemi në vijimin e veprimtarisë me qëllim rritjen e cilësisë në kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve. Ndryshe nga sa pretendon ankuesi, Urdhri nr.30, datë 08.02.2018 “Për dhënie mase disiplinore” nuk i është komunikuar si rezultat i kontrollit të ushtruar por është masë disiplinore për shkak të mospërbushjes së detyrave në kohë dhe efektivitetit siç ka rezultuar nga niveli shumë i ulët i volumit të të ardhurave nga shërbimi i arkëtimit të faturave të energjisë elektrike. Masa disiplinore të kësaj natyre janë dhënë për të gjithë punonjësit që janë konstatuar me nivel shumë të ulët të arkëtimit. Në lidhje me pretendimin për muajin Dhjetor 2017 konkretisht për kalimin nga “Fuqi Punëtore” në pozicionin “Punonjës me kohë të pjesshme” informojmë se kjo veprimtari ka qenë e kushtëzuar nga treguesit Ekonomiko-Financiar të Filialit dhe është vepruar në zbatim të Rregullores së Brëndshme për organizimin e punës nga drejtoria e filialit për arsye se numri i punonjësve të programuar për vitin 2017 ka qenë 96 dhe 21 “Punonjës me kohë të pjesshme”. Revokimi i bërë me shkresën nr.39, datë 22.01.2018 ka ardhur nga fakti se për vitin 2018 në programin Ekonomiko-Financiar janë programuar 107 punonjës nga 96 që ishin në vitin 2017. Shkeljet dhe parregullsitë e kryera nga Sh.S janë konstatuar në mënyrë të përsëritur, e vërtetuar me masa disiplinore të datës 15.04.2016³ “Për mangësi në kryerjen e shërbimeve postare dhe financiare”, masë disiplinore datë 20.07.2015 “Për parregullsi të konstatuara nga auditi i Drejtorisë së Përgjithshme” dhe masë disiplinore datë 08.02.2018. Ndryshe nga sa pretendohet në ankesë, Filiali i Postës Mat nuk ka asnjë informacion për asnjë punonjës se çfarë bindje politike ka, se në çfarë partie politike aderon si për ato punonjës që janë larguar nga puna për shkaqe të justifikuara dhe për ato punonjës që janë emëruar në punë”.*

³ Në nenin 203/1 të Kodit të Punës parashikohet se: “..... Afati i parashkrimit për masën disiplinore është një vit, nga momenti i marrjes së masës disiplinore, njoftuar me shkrim punëmarrësit”.

E. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së Sh.S, Komisioneri me shkresat nr. 712/4, datë 02.08.2018 dhe nr. 717/5, datë 16.08.2018 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 23.08.2018.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 23.08.2018, mori pjesë subjekti ankues dhe përfaqësuesi i Postës Shqiptare, Filiali Mat, A.V me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë zhvillimit të seancës palët konfirmuan dhe njëherë shpjegimet dhe prapësimet e tyre. Në relacionin shpjegues nr.501/2, datë 22.08.2018 të dorëzuar nga Filiali i Postës Mat gjatë zhvillimit të seancës, në lidhje me pretendimet për largimet e tjera të punonjësve, informohet se:

- L.S, ish drejtuese e Filialit Posta Mat është larguar nga puna nga Drejtoria e Përgjithshme e Shoqërisë Posta Shqiptare dhe jo nga Drejtoria e Filialit Mat.
- D.S Zyra Postare Xibër, H.G Zyra Postare Macullull, Sh.S Zyra Postare Komsit të rrethit Mat dhe D.K Zyra Postare Sllovë Dibër janë larguar nga puna për shkaqe të justifikuara.
- A.K Zyra Postare Klos, Sh.Z Zyra Postare Lis si dhe disa raste të tjera në Degën e Postës Dibër, Bulqizë dhe Mat janë realizuar në respektim të afateve të përcaktuara nga legjislacioni për shkurtimin e vendeve të punës.
- F.K është transferuar nga Zyra Postare Burrel në Zyrën Postare Peshkopi me dakordësinë e saj dhe vijon normalisht punën.

Subjekti ankues gjatë zhvillimit të seancës deklaroi⁴ se dhe dy punonjësit e tjerë anëtarë të LSI që janë larguar më vonë nga puna, D.S Zyra Postare Xibër dhe H.G Zyra Postare Macukull gjatë periudhës së fundvitit 2017 kanë kaluar si punonjës me kohë të pjesshme. Ankuesi në mbështetje të pretendimeve për aktivitetin politik të tij dhe të personave të tjerë të përmendur në ankesë, në përfundim të seancës dëgjimore dorëzoi këto prova:

- Vërtetim nr.256, datë 20.08.2018 të lëshuar nga subjekti “Lëvizja Socialiste për Integrim” në të cilin vërtetohet se L.S, D.S, A.K dhe F.K janë anëtarë të subjektit politik LSI.
- Vendimet nr.121, datë 15.06.2017, nr.133, datë 21.06.2017, të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor nr.16, për emërimin e L.S dhe G.G (djali i H.G zyra postare Macukull) si anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave për subjektin LSI.
- Vendimet nr.44, datë 09.06.2017, nr.139, datë 23.06.2017 të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor nr.16, për emërimin e Sh.Z dhe F.K si anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit për subjektin LSI.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u kërkua nga subjekti Filiali i Postës Mat që të dërgonin informacion në lidhje me:

⁴ Minuta 46 e regjistrimit të seancës dëgjimore.

- Grafikon, programet e kontrollit, relacionet dhe masat disiplinore të marra nga ana e drejtuesve të Filialit të Postës Mat nga periudha e fillimit të punës së drejtuesit të ri të institucionit (datë 10.11.2017)⁵.
 - Kur ka marrë dizeni Filiali i Postës Mat për ndryshimin e strukturës për vitin 2018 dhe a ka pasur punonjës të tjerë që kanë kaluar nga punonjës me kohë të plotë në punonjës me kohë të pjesshme⁶.
- F.** Subjekti ankues me shkresën datë 06.09.2018 ka dërguar pranë Komisionerit dokumentet si më poshtë: - Vendim nr. 32, datë 09.06.2017 të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor nr.16, për emërimin e A.B si anëtar të Komisionit të Qendrës së Votimit nr.0946 për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. – Vërtetim nr.256, datë 29.08.2018 të LSI Dega Mat në të cilin vërtetohet se: L.S, A.K, F.K, D.S dhe A.S (djali i subjektit ankues ka qenë vëzhgues në QV nr.0953, KZAZ nr.16) janë anëtarë të subjektit politik LSI Dega Mat.
- G.** Me shkresën nr.501/3, datë 10.10.2018 Filiali i Postës Mat ka dërguar pranë Komisionerit: - Program dhe Relacion Kontrolli nr.450, datë 19.07.2018 të zhvilluar në Zyrën Postare Fushë Bulqizë në të cilin janë konstatuar mangësi në kryerjen e Shërbimeve Postare dhe Financiare dhe në përfundim Drejtoria e Filialit ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për punonjësen E.D. - Program dhe Relacion Kontrolli nr.531, datë 20.09.2018 të zhvilluar në Zyrën Postare Shupenzë në të cilin janë konstatuar mangësi në kryerjen e Shërbimeve Postare dhe Financiare dhe në përfundim Drejtoria e Filialit ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për punonjësin A.N.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ankuesi Sh.S me Urdhrin e Brendshëm nr. 30, datë 29.01.2014 është emëruar nga Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a Filiali Mat në pozicionin si punonjës shërbimi në Zyrën Postare Koms. Posta Shqiptare Filiali Mat përbëhet nga 38 zyra të shpërndara në 3 rrethe: Mat, Dibër dhe Bulqizë. Dega Mat është e përbërë nga 14 zyra, një nga këto zyra është dhe Zyra Postare Koms e përbërë nga një punonjës, që ka qenë Sh.S.

Me shkresën nr.3445/1, datë 10.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare sh.a, A.B është emëruar “Drejtor” në Filialin e Postës Mat.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 38, datë 19.12.2017, Drejtori i Filialit të Postës Mat, ka urdhëruar kalimin e Sh.S nga pozicioni “Kryetar i Zyrës Postare” Koms në pozicionin “Punonjës me kohë të pjesshme”. Me shkresën nr.566, datë 29.12.2017, Drejtori i Filialit të Postës Mat ka njoftuar Sh.S mbi fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës bazuar në Kodin e Punës dhe në shkresën nr.3533, datë 16.11.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë Posta

⁵ Minuta 15 e regjistrimit të seancës dëgjimore.

⁶ Minuta 44.02 e regjistrimit të seancës dëgjimore.

Shqiptare sh.a⁷. Në pikën 1 të shkresës nr.3533, datë 16.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare sh.a shkruhet se: *“Filiali i postës nuk duhet të ketë asnjë punonjës (fuqi punëtore) me kohë të pjesshme”*.

Për sa më sipër, vlerësohet se Drejtori i Filialit të Postës Mat që në datë 16.11.2017 ka qenë në dijeni të shkresës nr.3533 në të cilën është kërkuar informacion për rishikimin e strukturës dhe që nuk duhet të kishte punonjës me kohë të pjesshme dhe përsëri në datë 19.12.2017 ka urdhëruar kalimin e Sh.S në punonjës me kohë të pjesshme, duke treguar një tendencë për të larguar ankuesin nga puna.

Me shkresën nr.566/1, datë 12.01.2018 është njoftuar Sh.S për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare në pasafatit të njoftimit 2 mujor, në datë 12.03.2018. Sh.S duke mos rënë dakord me vendimmarrjet e njëpasnjëshme, duke i quajtur të marra në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me një ankesë administrative⁸ në të cilën ka shprehur pretendimet e tija.

Subjekti ankues me shkresën nr.39, datë 22.01.2018 është njoftuar për revokimin e shkresës nr.566/1, datë 12.01.2018, “Njoftim për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës” duke e kthyer dhe njëherë Sh.S në punonjës me kohë të plotë, por në shkresë nuk tregohen arsyet e revokimit të urdhrit të mësipërm.

Drejtori i Filialit të Postës Mat, me Urdhrin e Brendshëm nr. 30, datë 08.02.2018 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me shkrim” për punonjës Sh.S me motivacionin për mospërbushje të detyrave në kohë dhe efektivitet siç ka rezultuar nga niveli i ulët i volumit të të ardhurave nga shërbimi i arkëtimit të faturave të OSHEE.

Në vlerësim të dokumenteve të dorëzuara nga palët rezultojnë se nga ana e drejtuesit të Filialit të Postës Mat, në datë 08.02.2018 janë dhënë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” për 24 punonjës të zyrave të ndryshme të Filialit të Postës Mat me motivacionin për mospërbushje të detyrave në kohë dhe efektivitet siç ka rezultuar nga niveli i ulët i volumit të të ardhurave nga shërbimi i arkëtimit të faturave të OSHEE, motivacion i njëjtë me subjektin ankues ku ndër të tjerët figurojnë dhe punonjësit: Sh.S, D.S, H.G të tre anëtarë të subjektin politik LSI.

Në lidhje me dhënien e masës disiplinore për Sh.S si rezultat i nivelit të ulët të volumit të të ardhurave nga shërbimi i arkëtimit të faturave të OSHEE, Filiali i Postës Mat ka informuar Komisionerin për nivelin e arkëtimeve të faturave të OSHEE për periudhë dhjetor 2017 dhe janar 2018, por Komisioneri vlerëson se nga data 19.12.2017 deri në datë 22.01.2018 Sh.S nuk ka qenë në të njëjtat kushte si punonjësit e tjerë pasi ka qenë si i punësuar me kohë të pjesshme dhe krahasimi me punonjësit e tjerë që kanë qenë me kohë të plotë nuk mund të realizohet.

Filiali i Postës Mat me shkresën nr. 69, datë 08.02.2018 ka miratuar programin e kontrollit në Zyrën Postare Koms. Objekt i kontrollit ka qenë zbatimi i akt-marrëveshjeve, udhëzimeve, shkresave, rregulloreve, etj, për periudhën 01.04.2017 deri me 30.06.2017 dhe 01-31.12.2017. Në relacionin e hartuar nga grupi i kontrollit janë konstatuar mangësi gjatë ushtrimit të detyrës nga

⁷ Lënda: Kërkohej informacion mbi rishikimin e strukturës.

⁸ Ankuesi nuk disponon kopje të ankesës.

punonjësi Sh.S të cilat konstatonin se: - Kishte parregullsi në zbatimin e Akt-Marrëveshjes nr.3341, nr.2038 mes ISSH dhe Posta Shqiptare sh.a dhe Udhëzimit nr.3, datë 23.02.2015 ku konkretisht janë konstatuar raste të tërheqjes së pensionit nga persona të tretë të paautorizuar. – Kishte parregullsi në shpërndarjen e përfitimit të paafësive për kujdestarët ku përfitimi është tërhequr nga persona të tretë të paautorizuar. – Kishte parregullsi në shpërndarjen e ndihmës ekonomike ku përfitimi është tërhequr nga bashkëshortët dhe jo bashkëshortet të cilat ishin përfituese në listë-pagesë.

Me shkresën nr.210, datë 13.03.2018 të Filialit të Postës Mat, Sh.S është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të justifikuara për parregullsi dhe mospërbushje të detyrës në kohë, cilësi e efektivitetit siç ka rezultuar edhe në konstatimet e dokumentuara në akt-kontrollin e datës 08.02.2018.

Në nenin 15/a të Kontratës së Punës datë 20.03.2014 të lidhur mes Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare dhe Sh.S shkruhet: *“Zgjidhja e menjëhershme. a.Punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të menjëhershme edhe kur kontrata është pa afat, kur ka shkaqe të arsyeshme, (të vlerësuara nga ai si të tilla) dhe kur këto shkaqe lidhen direkt me mosrespektimin e kushteve dhe afateve të kontratës nga pala tjetër.....”*.

Në shkresën nr.4545/2, datë 30.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare sh.a, mbi zbatimin e marrëveshjes 1932/4537, datë 21.08.2008 dhe 2038/3341, datë 12.06.2014 me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, përcaktohen rastet⁹ se kur merret masa administrative e largimit nga puna për punonjësit që paguajnë në kundërshtim me marrëveshjen e sipërcituar, dhe një nga këto raste është konstatuar si parregullsi dhe për punonjësin Sh.S.

Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin e dërguar nga palët rezulton se nga Filiali i Postës Mat janë organizuar programe kontrolli të njëjta me Zyrën Postare Komsi dhe në Zyrat Postare, Macukull¹⁰, Xibër, Fushë Bulqizë dhe Shupenzë në të cilat janë konstatuar parregullsi të ngjashme me parregullsitë e konstatuara në Zyrën Postare Komsi. Për parregullsitë e konstatuara nga grupi i kontrollit në këto zyra, nga ana e Drejtorit të Filialit të Postës Mat është marrë masa e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit, Sh.S Zyra Postare Komsi, H.G Zyra Postare Macukull, D.S Zyra Postare Xibër, të gjithë këto anëtarë të subjektit politik LSI dhe masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për punonjësit E.D Zyra Postare Fushë Bulqizë dhe A.N Zyra Postare Shupenzë.

Në vlerësim të dokumenteve të sipërcituara, konstatohet se nga ana e Drejtuesit të Filialit të Postës Mat nuk është marrë e njëjta masë disiplinore me largim nga puna për punonjësit, E.D Zyra Postare Fushë Bulqizë dhe A.N Zyra Postare Shupenzë të cilët kanë rezultuar në shkelje të zbatimit të Akt-Marrëveshjes nr.3341, nr.2038 midis ISSH Tiranë dhe Posta Shqiptare sh.a si dhe Udhëzimit nr.3, datë 23.02.2015 në të cilën shprehet qartë se punonjësit të cilët nuk zbatojnë marrëveshjen, merret masa administrative “Largim nga puna”.

⁹ - Në rast se pensioni nuk i paguhet vetë pensionistit kundrejt paraqitjes së dokumentave personale të identifikimit. – Nënshkruan në emër të të tjerëve edhe pse nuk ka ankesa.

¹⁰ Program Kontrolli nr.138, datë 13.02.2018 në Zyrën Postare Macukull, Program Kontrolli nr.139, datë 15.02.2018 në Zyrën Postare Xibër, Program Kontrolli nr. 450, datë 19.07.2018 në Zyrën Postare Fushë Bulqizë dhe Program Kontrolli nr.531, datë 20.09.2018 në Zyrën Postare Shupenzë.

Veprimet tendencioze të Drejtorit të Filialit të Postës Mat, në drejtim të ankuesit Sh.S përforcohen më tepër nga qëndrimet negative të mbajtura në vijimësi nga ana e drejtuesit, fillimisht duke e kaluar në punonjës me kohë të pjesshme në muajin Dhjetor 2017 pavarësisht se ishte në dijeni se nuk duhet të kishte punonjës me kohë të pjesshme, pastaj dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” në datë 08.02.2018, më vonë në organizimin e programit të kontrollit në datë 08.02.2018, ndërkohë që programet e kontrollit për punonjësit e tjerë janë organizuar në datë 19.07.2018 dhe 20.09.2018 dhe në përfundim me marrjen e masave të ndryshme disiplinore për parregullsi të njëjta për punonjësit: Sh.S, E.D dhe A.N për të cilët ankuesi nuk ka patur pretendime që janë anëtarë të subjektit politik LSI.

Në përfundim, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹¹, Komisioneri gjykon se Sh.S i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Drejtorit të Filialit të Postës Mat.

Ankuesi Sh.S, vendimin e largimit nga puna e ka bërë objekt të shqyrtimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, e cila me Vendimin nr.136, datë 17.07.2018 ka vendosur detyrimin e të paditurit Posta Shqiptare Filiali Mat të dëmshpërblejë paditësin Sh.S si rezultat i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar. Vendimi nuk është i formës së prerë pasi është kundërshtuar në Gjykatën e Apelit nga ana e Postës Shqiptare Filiali Mat.

B. Shkaku i mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e drejtuesit të Filialit të Postës Mat, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur (bindja politike) nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹² dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Pretendimi i Sh.S se shkak për diskriminim ndaj tij janë bërë bindjet e tij politike, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit 10221/2010. Nga shqyrtimi i dokumenteve nga Komisioneri, rezulton se Sh.S është anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, e vërtetuar me kartën e anëtarësisë nr.5736, datë 22.04.2016, si dhe Vërtetim nr.16, datë 16.05.2018 të lëshuar nga subjekti politik LSI, dega Mat.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Filialit të Postës Mat, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji

¹¹ Neni 7, pika 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

¹² Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹³, për të cilin ankuesi pretendon diskriminim dhe trajtimin të pafavorshëm të tij.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, në të cilat u shpall fituese subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë, A.B u emërua “Drejtor” i Filialit të Postës Mat, i cili gjatë procesit zgjedhor të vitit 2017 ishte aktivizuar si anëtar i propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste në Komisionin e Qendrës së Votimit nr.0946, të KZAZ nr.16 të Qarkut Dibër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Vetëm për punonjësit, Sh.S, D.S dhe H.G si anëtarë të subjektit politik LSI në periudhën dhjetor 2017, ishte marrë masa e kalimit nga punonjës me kohë të plotë në punonjës me kohë të pjesshme, pavarësisht se Drejtori i Filialit të Postës Mat që në datë 16.11.2017 ka qenë në dijeni të shkresës nr.3533 në të cilën është kërkuar informacion për rishikimin e strukturës dhe që nuk duhet të kishte punonjës me kohë të pjesshme.
- Gjatë muajit Shkurt 2018 janë organizuar programe kontrolli vetëm për Zyrat Postare, Koms, Xibër dhe Macukull ku kanë qenë të punësuar anëtarë të subjektit politik LSI, ndërkohë që programet e tjera të kontrollit janë organizuar pas një periudhe kohore pesë dhe gjashtë mujore. Në lidhje me këtë, për të provuar se ka pasur planifikim dhe një grafik për organizimin e kontrolleve në 38 zyrat postare në varësi, Filiali i Postës Mat nuk solli prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se organizimi i programit të kontrollit ka qenë tendencioz dhe është bërë për largimin e tij nga puna.
- Në ndryshim për shkeljet e konstatuara nga grupet e kontrollit për punonjësit Sh.S, D.S dhe H.G është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ndërsa për punonjësit E.D dhe A.N është marrë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, ndërkohë që në të gjitha relacionet e grupeve të kontrollit është konstatuar shkelja e zbatimit të Akt-Marrëveshjes nr.3341, nr.2038 midis ISSH Tiranë dhe Posta Shqiptare sh.a si dhe Udhëzimit nr.3, datë 23.02.2015 në të cilën shprehet qartë se punonjësit të cilët nuk zbatojnë marrëveshjen, merret masa administrative “Largim nga puna”.

Në vlerësim përse më sipër, Komisioneri gjykon se në rastin e punonjësit Sh.S, rezulton një shkelje e Akt-Marrëveshjes nr.3341, nr.2038 të lidhur mes ISSH Tiranë dhe Postës Shqiptare sh.a, por nga ana tjetër nga vetë punëdhënësi për rastet e shkeljeve të të njëjtës natyrë, të konstatuar në Zyrat Postare Fushë Bulqizë dhe Shupenzë është marrë masë disiplinore më e lehtë, gjë që vlerësohet se dhe në rastin e Sh.S, nga ana e Filialit të Postës Mat mund të ishte marrë masë disiplinore më e lehtë dhe jo largim nga puna.

Mbështetur në faktet dhe provat e administruara, gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se të gjitha veprimet e kryera në dëm të ankuesit janë bërë pas emërimit të A.B si drejtues i Filialit të Postës Mat.

¹³ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Filiali i Postës Mat. Pra, në këtë rast Filiali i Postës Mat, duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme.

Neni 82, pikat 2 dhe 3 e Kodit të Procedurës Administrative, lidhur me barrën e provës, parashikon se: *“2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme”.*

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, Filiali i Postës Mat nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se kalimi në punonjës me kohë të pjesshme, organizimi i programit të kontrollit dhe largimi nga puna, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike.

Nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, veprimet e kryera nga ana e Filialit të Postës Mat në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, nga ana profesionale dhe morale.

Mbrojtja dhe gëzimi i të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës së RSH-së¹⁴ sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹⁵

¹⁴ Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar.

¹⁵ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49.

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja¹⁶ është shprehur se: “...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësisë së punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm.”. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës¹⁷.

Po ashtu, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar¹⁸, dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, germa d) parashikohet se: “...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzania, besimi fetar, **opinionit politik**, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁹. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit

¹⁶ Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

¹⁷ “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

¹⁸ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

¹⁹ Referuar neni 3, pika 8, e LMD-së.

në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se Sh.S, është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Filialit të Postës Mat, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit Sh.S, nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Mat, për shkak të bindjes politike.
2. Në referim të pikës 1, Filiali i Postës Shqiptare sh.a Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e Sh.S në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Filiali i Postës Shqiptare sh.a Mat, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA